



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, në vazhdimin e seancës së 50-të, të mbajtur më datë 23.07.2021 morri

VENDIM

Denoncimi i dorëzuar nga parashtrues i panjohur ----- në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në bazë të të cilit është formuar lënda me numër 12-2014/1 të datës 21.05.2020, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, pasi shqyrtimit të përmbajtjes së lëndës, përcaktoi se nuk ka elemente për veprim kompetent mbi të njëjtën.

Lënda me numër 12 –2014/1 të datës 21.05.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsytim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsytim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsytim

Lënda me numër 12-2014/1 të datës 21.05.2020 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtrues i njohur----- .

Në aplikim, parashtruesi pohon që të kontrollojë EVN -në se si i dërgon faturat, ndërsa pohimet nga deklaratat e dhëna në media nga drejtori se faturat janë bërë sipas një formule dhe ata që kishin fatura të mëdha të drejtohen në EVN ose vet ti regjistrojnë orët e shpenzuara KW .

Pas shqyrtimit dhe studimit të pohimeve nga denoncimi, KSHPK -ja arriti në përfundimin se e njëjta përmban pohime dhe shprehen pakënaqësi personale të parashtruesit, dhe nuk tregon paligjshmëri specifike që mund të tregojnë veprime korruptive. Prandaj, në seancë, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vlerësoi se nuk ka elementë për veprimin e tij kompetent sipas lëndës në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Duke mar parasysh të theksuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.12/19), vendosi si në dispozitat e këtij vendimi.

Përgaditi; M.r B.KSH, Këshilltar
Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ СХТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРҮЕТАРИ
Biljana Ivanovska

